



STATUTI I ASSE-s

(Shoqata Shqiptare për Studimet në Gjuhën Angleze – Albanian Society for the Study of English)

Neni 1 – Emri i shoqatës

Kjo shoqatë do të njihet me emrin Shoqata Shqiptare për Studimet në Gjuhën Angleze (ASSE – Albanian Society for the Study of English).

Neni 2 – Vendndodhja

Shoqata është e vendosur pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Vlorës. Adresa është: Universiteti i Vlorës, Lagjja. Pavarësia, Sheshi Vlorë-Skelë, Godina A, Vlorë, Shqipëri.

Neni 3 – Qëllimi

Shoqata ka për qëllim të:

- ◆ Nxisë dhe çojë përpara studimin e gjuhës angleze në Shqipëri
- ◆ Mbështesë kërkimin shkencor në lëmin e studimeve angleze dhe të botës anglofone në Shqipëri
- ◆ Krijojë lidhje ndërmjet kërkuesve dhe mësimeve të gjuhës angleze në Shqipëri dhe atyre në vendet e tjera
- ◆ Ndihmojë në përmirësimin e nivelit të mësimeve të gjuhës angleze
- ◆ Organizojë takime, seminare, konferenca dhe aktivitete të tjera me karakter shkencor në fushën e studimeve angleze
- ◆ Nxisë dhe promovojë botimet në fushën e anglistikës
- ◆ Krijojë një hapësirë të mirëfilltë shkencore për ata që merren me studime në gjuhën angleze
- ◆ Përfaqësohet në ESSE (European Society for the Study of English).

Neni 4 – Anëtarësimi

ASSE është shoqate joqeveritare dhe jofitimprurëse e hapur për të gjithë ata kërkues, mësimeve, specialistë të studimeve të gjuhës angleze që punojnë në nivelin universitar

në Shqipëri. Shoqata mirëpret gjithashtu të gjithë ata kërkues, mësues e specialistë ndërkombëtarë që punojnë dhe kontribuojnë për nxitjen e këtyre studimeve në Shqipëri.

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga dy kategori:

- a) *Anëtarët e thjeshtë me të drejta dhe detyrime të plota*: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues, mësime të gjuhës angleze që operojnë në nivelin universitar përmes aktivitetit të tyre mësime, kërkues e shkencor.
- b) *Anëtarë nderi*: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata njerëz dhe personalitete me kontribute të veçanta në studimin e anglishtes në Shqipëri. Statusi i anëtarit të nderit propozohet nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohet në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit çlirohen nga detyrimi i kuotës së anëtarësimit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta me anëtarët e thjeshtë të ASSE-s.

Neni 5 – Procedura e anëtarësimit

Çdokush me interesa profesionale e shkencore në studimet angleze që punon në nivelin universitar mund të aplikojë për tu anëtarësuar në ASSE. Për tu anëtarësuar, personat që dëshirojnë të bëjnë pjesë në ASSE duhet fillimisht të plotësojnë një formular elektronik, i cili përmban pyetje që verifikojnë statusin e aplikantit dhe provojnë njohjen e tij me statutin e ASSE-s. Të drejtën për miratimin e aplikimeve për anëtarësimit e ka Këshilli Drejtues. Pas anëtarësimit, këta persona duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit dhe të regjistrohen në listën e anëtarëve. Përjashtohen nga kuota e anëtarësimit anëtarët e nderit të shoqatës.

Neni 6 – Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të shoqatës

- a) Të gjithë anëtarët e ASSE-s kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet e shoqatës.
- b) Të japin mendime dhe rekomandime për punën dhe veprimtarinë e shoqatës.
- c) Të ushtrojnë të drejtën e votës për të zgjedhur organet drejtuese të ASSE-s.
- d) Anëtarët e thjeshtë duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit sipas mënyrave dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli Drejtues dhe miratuar nga Mbledhja e Përgjithshme. Kjo u jep të drejtën anëtarëve të përfitojnë revistën shkencore të shoqatës si dhe Newsletter-in e saj. Të gjithë anëtarët që paguajnë kuotën vjetore rregullisht kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamblenë e Shoqatës me të drejtë vote.
- e) Anëtarët e nderit nuk kanë detyrime financiare kundrejt shoqatës. Ata mund të përfitojnë revistën shkencore dhe Newsletter-in e shoqatës, por nuk kanë të drejtë vote në asamble.

Anëtarësimit në ASSE mund të përfundojë kur anëtar:

- a) jep dorëheqjen
- b) kur përjashtohet nga shoqata për arsye të përcaktuara në nenin 7
- c) kur ndahet nga jeta.

Neni 7 – Përjashtimi nga shoqata

Përrjashtimi nga shoqata ndodh në rastet e mëposhtme:

- a) Për mosrespektim dhe thyerje të detyrimeve të përcaktuara nga statuti i shoqatës
- b) Për mospagim të kuotës vjetore të anëtarësimit
- c) Për sjellje dhe qëndrime që mund të cenojnë nderin, dinjitetin, figurën dhe financat e shoqatës.

Neni 8 - Organet e shoqatës

Në organet drejtuese të shoqatës bëjnë pjesë:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Këshilli Drejtues

Neni 9 - Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës dhe është organi më i lartë i saj. Asambleja e Përgjithshme thirret një herë në dy vjet, të hënën e parë të marsit për:

- a) të miratuar buxhetin,
- b) të përcaktuar planin e aktiviteteve të shoqatës,
- c) të vlerësuar punën e Këshillit drejtues,
- d) të bërë ndryshime të mundshme në statut,
- e) të zgjedhur anëtarët e këshillit drejtues të shoqatës,
- f) të marrë vendime të tjera me karakter administrativ.

Të gjithë anëtarët e asamblesë njoftohen 30 ditë përpara për thirrjen e asamblesë, vendin, datën e zhvillimit të saj si dhe rendin e ditës. Pjesëmarrja minimale e nevojshme për zhvillimin e punimeve të asamblesë është 50 + 1 për qind e anëtarëve. Asambleja i kërkon kryetarit të shoqatës që të drejtojë punimet e asamblesë si dhe zgjedh një sekretar për të mbajtur proces-verbalin e punimeve.

Pesëmbëdhjetë ditë përpara fillimit të punimeve të asamblesë duhet të bëhen të njohura: a) raporti i kryetarit të shoqatës në lidhje me ecurinë e saj si dhe punën e bërë nga Këshilli Drejtues që nga asambleja e mëparshme, b) raporti i drejtorit të thesarit për buxhetin e ASSE-s, c) rendi i ditës së asamblesë i miratuar nga Këshilli Drejtues, d) lista e kandidateve për në Këshillin Drejtues. Propozimet për kandidatë në Këshillin Drejtues të ASSE-s duhet t'i dërgohen Këshillit Drejtues jo më vonë se 30 ditë para zhvillimit të punimeve të asamblesë.

Raporti i kryetarit të shoqatës, buxheti apo ndryshime të tjera në statut miratohen me votim të hapur, kurse kandidatet për në Këshillin Drejtues të ASSE-s zgjidhen me votim të fshehtë.

Anëtarët e asamblesë mund të përfaqësohen në mungesë nga një anëtar tjetër i shoqatës vetëm në rast se kjo shoqërohet me letër delegimi. Çdo anëtar i shoqatës ka të drejtën të përfaqësojë me delegim jo më shume se një anëtar tjetër të saj. Për votimin e kandidateve për në Këshillin Drejtues të ASSE-s anëtarët e pranishëm në asamble dorëzojnë secili flete votimin e vet të plotësuar në kutinë e votimit, kurse anëtarët që mungojnë duhet të dërgojnë fletëvotimin e tyre në zarf të firmosur.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe në raste të jashtëzakonshme nga Këshilli Drejtues ose nga një e treta e anëtarëve të Asamblesë me procedura të njëjta si një mbledhje e zakonshme e asamblesë. Kjo mund të ndodhë në rastet kur:

- a) është e nevojshme për të diskutuar ndonjë problem të ngutshëm
- b) paraqitet ndonjë mocion
- c) propozohen përjashtime nga shoqata apo për të shpërndarë shoqatën etj.

Asambleja e jashtëzakonshme duhet të thirret të paktën pesë ditë përpara zhvillimit të punimeve.

Neni 10 – Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues është organi ekzekutiv i shoqatës që drejton dhe administron aktivitetin e saj në përputhje me synimet e nenet e përcaktuara në statut dhe legjislacionin e shtetit shqiptar. Këshilli Drejtues zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përbehet nga pesë anëtarë. Këshilli Drejtues zgjidhet çdo dy vjet, përveç rasteve për mocion mosbesimi si dhe anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të rikandidojnë vazhdimisht.

Këshillit Drejtues i ASSE-s:

- është përgjegjës për aktivitetin e ASSE-s
- thërret Asamblenë e Përgjithshme
- propozon ndryshime apo amendamente në statut
- i dorëzon Asamblesë së Përgjithshme raportin për veprimtarinë e shoqatës dhe shpenzimet e kryera, përdorimin dhe administrimin e buxhetit
- diskuton planin e aktiviteteve të shoqatës
- përcakton buxhetin
- miraton kuotën e anëtarësimit si dhe përcakton modalitetet për derdhjen e kuotës së anëtarësimit
- miraton aplikimet për anëtarësim si dhe bën propozimet për anëtarët e nderit të shoqatës pas marrjes së aplikimeve të mundshme për këtë status.
- është organi apelues për procedurat disiplinore dhe vendos për përjashtimet nga anëtarësimi në shoqatë
- mund të ngrëjë komisione të posaçme për probleme të veçanta.

Këshilli Drejtues thirret nga kryetari i shoqatës ose kur e kërkon një e dyta e këshillit. Vendimet merren me shumicë votash dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë të këshillit, ndër të cilët kryetari dhe një nga drejtuesit e tjerë, sekretari ose drejtori i thesarit. Përveç mbledhjeve standard lejohet edhe forma virtuale e mbledhjeve, përmes postës elektronike apo Internet-it, veçanërisht në raste emergjente dhe këto mbledhje kanë po të njëjtën vlerë me mbledhjet e zakonshme.

Këshilli Drejtues zgjedh nga radhët e veta kryetarin, sekretarin dhe drejtorin e thesarit si dhe përcakton funksionet dhe detyrat e anëtarëve të tjerë.

Neni 11 – Kryetari i Shoqatës

Kryetari i Shoqatës është përfaqësuesi zyrtar i shoqatës në marrëdhënie me të tretët. Kryetari i Shoqatës:

- thërret mbledhjet e Këshillit Drejtues

- thërret dhe kryeson punimet e Asamblesë së Përgjithshme
- i propozon Këshillit Drejtues planin e aktiviteteve të shoqatës
- autorizon veprimet financiare të shoqatës
- firmos vendimet e Këshillit Drejtues dhe korrespondencën e shoqatës.

Në rastet kur kryetari nuk është i pranishëm për arsye objektive mund ta delegojë firmën e vet tek sekretari ose edhe tek ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues.

Neni 12 – Sekretari i Shoqatës

Sekretari i Shoqatës është përgjegjës për dokumentacionin e shoqatës. Sekretari përpilon dhe ruan gjithë dokumentacionin që vërteton veprimtarinë e shoqatës.

Neni 13 – Drejtori i Thesarit

Drejtori i Thesarit është përgjegjës për financat e shoqatës. Ai kryen dhe regjistron të gjitha veprimet financiare të shoqatës. Drejtori i Thesarit sugjeron buxhetin e shoqatës si dhe përgatit raportin financiar për Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 14 - Anëtarët e tjerë

Anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues përgjigjen për organizimin e aktiviteteve të tjera të shoqatës, si organizimi i konferencës së përvitshme shkencore, botimin e buletinit shkencor apo përgatitjen e Newsletter-it të shoqatës etj.

Neni 15 – Fondet e shoqatës

Burimet kryesore financiare të shoqatës janë:

- a) derdhjet nga kuotat e anëtarësimit
- b) të ardhura nga aktivitetet e ndryshme të parashikuara për tu zhvilluar
- c) kontribute të ndryshme në formë sponsorizimesh, donacionesh apo subvencionesh nga organizata shtetërore apo vetë-qeverisëse, programe të ndryshme, grante etj.

Fondet e shoqatës do të administrohen nga Këshillit Drejtues dhe do të bëhen publike për anëtarët me synim transparencën në administrimin dhe përdorimin e këtyre fondeve. Ato do t'i dorëzohen Drejtorit të Thesarit për t'i regjistruar dhe administruar. Këto fonde do të përdoren për organizimin e aktiviteteve të shoqatës si konferenca, seminare, workshop-e apo për botimet e ndryshme të shoqatës.

Fondet mund të përdoren edhe për mbulime shpenzimesh të tjera si ndihmë financiare për pjesëmarrjen e anëtarëve në konferenca shkencore, për qëllime shoqërore apo veprimtari bamirësie apo aktivitete të tjera të miratuara.

Neni 16 – Shkrirja e shoqatës

Shoqata mund të shkrihet :

- a) me kërkesën e dy të tretave të anëtarëve
- b) kur veprimtaria e saj bie në kundërshtim me statutin dhe dispozitat ligjore në fuqi.